


UDHËZUES PËR APLIKIM

PËRKRAHJE PËR PËRFAQËSIM RAJONAL/NDËRKOMBËTAR
TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Bashkëfinancuar nga:



Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC





Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), me qëllim të fuqizimit të rolit të shoqërisë civile në hartim dhe zbatim të politikave të cilat prekin komunitetin dhe publikun e gjerë përmes nxitjes së veprimeve të përbashkëta me partnerët, ofron përkrahje financiare për përfaqësim rajonal/ndërkombëtar të organizatave joqeveritare.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Për përkrahje për përfaqësim mund të aplikojnë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare vendore, përveç kategorive të OJQ-ve të përjashtuara si më poshtë:

- Përkundër statusit të tyre juridik, klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore ose organizatat fetare, që janë të regjistruara si OJQ, nuk janë synim i granteve të KCSF-së.
- Ngjashëm, OJQ-të që përfaqësojnë biznese ose subjekte të ngjashme për të cilat është e qartë që kanë aftësi financiare për të mbuluar shpenzimet e organizatës së tyre ose për të përkrahur aktivitetet e tyre, nuk janë synim i granteve të KCSF-së.
- Po ashtu, degët e OJQ-ve të huaja dhe ndërkombëtare të regjistruara në Kosovë nuk kanë të drejtë të aplikojnë.

Përfaqësues të organizatave konsiderohen stafi i organizatës sipas autorizimit për përfaqësim të nënshkruar nga pozitat kompetente në kuadër të organizatës.

Organizata aplikuese nuk duhet të jetë e udhëhequr nga Persona të Ekspozuar Politikisht (PEP)¹ si dhe pranon dhe përkushtohet t'i zbatojë Vlerat themelore për grantet e EJA.²

¹ Për më shumë rreth kufizimeve në lidhje me personat e ekspozuar politikisht (PEP), shih formularin për aplikim. Të gjitha organizatat aplikuese janë të detyruara të deklarojnë se asnjë person në pozicionet drejtuese, sipas listës dhe përcaktimit të Personave të ekspozuar politikisht, të paraqitura në formularin e aplikimit, nuk bien nën këtë kategori.

² Për më shumë rreth Vlerave themelore për grante të EJA, shih formularin për aplikim. Të gjitha organizatat aplikuese janë të detyruara që t'i pranojnë dhe të përkushtohen që do t'i përmbahen Vlerave themelore për grante të EJA.

KRITERET E PËRZGJEDHJES

Që aplikanti të mund të jetë përfitues i këtij granti, përfaqësimi duhet të synojë së paku njërin nga pikat e mëposhtme:

- Prezantimi i punës së organizatës para një audience rajonale/ndërkombëtare.
- Prezantimi ose avokimi për çështje të caktuara me interes për organizatën apo vendin në forume rajonale/ndërkombëtare.
- Krijimi i mundësive për rrjetëzim, apo bashkëpunime strategjike me organizata dhe donatorë të tjerë rajonalë/ndërkombëtarë.
- Prezantimi i përvojave dhe praktikave të funksionimit të organizatës apo trajtimit të çështjeve me interes për vendin apo organizatën.

Aktiviteti duhet të jetë i ndërlidhur me punën e organizatës (misionin/fushat e veprimit) të cilën e përfaqëson. Të gjitha aplikimet do të shqyrtohen individualisht dhe do të vlerësohen nga komisioni bazuar në plotësimin e kritereve të mësipërme.

Përparësi do të kenë aplikuesit që plotësojnë së paku njërin nga pikat e mëposhtme:

- Kanë rol aktiv gjatë pjesëmarrjes dhe do të ofrojnë kontribut të drejtpërdrejtë në aktivitet.
- Aplikojnë për herë të parë në këtë skemë.
- Mbulojnë ndonjë pjesë të shpenzimeve nga burime të tjera.

Aplikantët dhe organizatat joqeveritare mund të jenë përfitues të grantit **një herë brenda vitit**.

Ndryshe nga rregulla për organizatën, përfitues i përkrahjes për përfaqësim nuk mund të jetë dy herë i njejtë përfaqësues i organizatës.

Në parim do të financohet vetëm një përfaqësues nga një organizatë, por në rast të arsyeshmërisë së fuqishme të nevojës së udhëtimit të dy personave, në raste të jashtëzakonshme mund të konsiderohet edhe përkrahja për personin e dytë. Në raste të tilla, përfituesit udhëzohen që t'i kushtojnë vëmendje udhëzimeve rreth rimbursimeve të specifikuar në faqen e fundit të këtij udhëzuesi.

Grantistët institucional të mbështetur nga EJA Kosovë nuk mund të aplikojnë për përkrahje nga kjo thirrje.

CILAT AKTIVITETE PËRKRAHEN?

Përfaqësimi në kongrese, konferenca, seminare, punëtori, simpoziume, festivale, takime strategjike, takime të ndryshme të rrjeteve (kuvendet e anëtarëve, bordet, komisionet), takime avokuese.

Përkrahja nuk mbështet aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve.

DERI NË ÇFARË SHUME OFROHET PËRKRAHJE?

Shuma maksimale e përkrahjes është 1,000 EUR

CILAT SHPENZIME PRANOHEN?

Shpenzimet e pranueshme

- Shpenzimet e transportit (aeroplan, autobus, tren, veturë), vetëm në klasë ekonomike.
- Shpenzimet e regjistrimit në aktivitet.
- Shpenzimet e fjetjes.
- Transporti lokal.
- Viza (maksimum 150 euro)

*Përkrahja e shpenzimeve për kategori të paraqitura në aplikacion (përkrahja e plotë ose e pjesshme e tyre) është në diskrecion të komisionit vlerësues.

Shpenzimet e papranueshme

- Shpenzimet për ushqim.
- Shpenzimet për vizat e marrura paraprakisht dhe të vizave që nuk ndërlidhen me aktivitetin për të cilin aplikohet.
- Pagesat e realizuara para njoftimit me vendim pozitiv për aplikimin për grant, përveç rasteve të jashtëzakonshme kur ka arsyeshmëri të fuqishme për pagesë të shpenzimeve të veçanta para pranimit të njoftimit.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikimi bëhet përmes [sistemit online të aplikimit](#). Udhëzimet për regjistrim dhe përdorim të sistemit të aplikimit mund t'i gjeni në [webfaqe](#). Në rast se hasni vështirësi ose keni nevojë për sqarime shtesë sistemit të aplikimit, ju lutemi ndjehuni të lirë të na kontaktoni përmes email-it ose telefonit.

Dokumentet që duhet t'i dorëzoni përmes sistemit online të aplikimit:

- Formularin e aplikimit.
- Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së lëshuar nga Departamenti për OJQ.
- Konfirmimin nga punëdhënësi (autorizim për pjesëmarrje në emër të organizatës) duke specifikuar pozitën dhe rolin në organizatë.
- Ftesën dhe agjendën e aktivitetit/ngjarjes.
- Çfarëdo dokumenti që dëshmon mbulimin e ndonjë shpenzimi nga organizatorët, organizata, apo palë të treta (nëse aplikohet).

Aplikacioni duhet të dorëzohet së paku 15 ditë para mbajtjes së aktivitetit/ngjarjes. Aplikanti duhet të ketë parasysh edhe kohën e paraparë për aplikim për vizë për ato vende që kërkohet viza.

Aplikacionet e pa kompletuara nuk do të vlerësohen.

NËNSHKRIMI I KONTRATËS DHE RIMBURSIMI

Në rastet e përkrahjes së aplikacionit, pas pranimit të përgjigjes pozitive, nga përfaqësuesi i organizatës aplikuese do të kërkohet që të dërgohen informatat e nevojshme për kontraktim, ku hyjnë të dhënat e individit dhe numri i llogarisë bankare. Shuma e përkrahjes që do të transferohet është 50% pas nënshkrimit të kontratës dhe 50% pas pranimit të shpenzimeve të bëra në udhëtim.

Në rastet kur nevojitet pajisje me vizë, transferimi i mjeteve do të bëhet pas dorëzimit të dëshmisë së pajisjes me vizë (kopja e vizës). Pjesa tjetër e shumës së grantit do të transferohet pas kthimit nga udhëtimi.

Për rimbursim përfituesi duhet t'i dërgojë këto dokumente: 1) formularin për rimbursim (shkarkohet në uebfaqen e [KCSF-së](#); 2) dëshmitë për të gjitha shpenzimet e bëra për të cilat kërkohet rimbursim (fatura, bileta, boarding pass, etj) dhe 3) raportin i cili duhet të përmbajë informata të përmbledhura rreth aktivitetit në të cilin është marrë pjesë.

Në rastet kur përkrahen dy përfaqësues të së njëjtës organizatë, individët e përkrahur duhet të kenë parasysh që nënshkrimi i kontratave dhe, rrjedhimisht, të gjitha obligimet që dalin nga kontrata dhe rimbursimi i shpenzimeve do të bëhen për individë. Kështu, secili individ i përkrahur do të ketë kontratën për përkrahje dhe shpenzimet që do të mbuloohen në kuadër të saj. Për shpenzimet e natyrës së përbashkët që bëhen me qëllim të uljes së shpenzimeve të përgjithshme të udhëtimit, të përkrahurit udhëzohen që të vendosin në mënyrë të përbashkët se në cilën nga kontratat do të vendosin shpenzimet në fjalë, mbi të cilin vendim më pas zbatohet procedura e rimbursimit.

Të gjitha dokumentet origjinale duhet të dorëzohen në adresën Musa Tolaj, Lam A, H1, Kat.12, nr. 65-1, Lakrishtë, 10 000 Prishtinë, jo më vonë se 10 ditë pune pas kthimit nga udhëtimi. Rimbursimi do të realizohet më së voni 10 ditë pune nga konfirmimi i rregullsisë së dokumenteve (pranimi i shpenzimeve). Shuma që do të rimbursohet do të transferohet në llogarinë bankare të aplikuesit të paraqitur në formularin aplikimit.

PËRMBYLLJA E KONTRATËS

Pas pranimit të shpenzimeve dhe transferimit të rimbursimit, kontrata konsiderohet e mbyllur.

Në rast që përfituesi nuk dorëzon dokumentet e kërkuara apo nuk respekton afatin kohor për dorëzim të dokumenteve, nuk do të pranohet rimbursimi dhe detyrohet t'i kthejë mjetet e marra pas nënshkrimit të kontratës.

KONTAKTI

Të gjitha pyetjet mund të dërgohen në e-mailin aja@kcsfoundation.org.

Versioni aktual i publikuar: maj, 2024